



Prishtinë, 03 tetor 2016
Kodi i ZRRE-së: V_850_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 16 dhe Nenit 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 4.2 dhe Nenit 22.2 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
- Dispozitat e Nenit 7.4 të Licencës së Operatorit të Tregut,
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 14.09.2016 për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit: Raporti i Derogimeve për Kodin e Matjes dhe Rregullat e Tregut,

në seancën e mbajtur me datë 03.10.2016, nxori këtë:

VENDIM

I. **APROVOHET** kërkesa e KOSTT-it për **Derogimet për Kodin e Matjes dhe Rregullat e Tregut** si në shtojcë të këtij vendimi.

Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 14 shtator 2016 ka pranuar kërkesën e KOSTT-it për derogim në zbatimin e disa dispozitave nga Kodi i Matjes dhe Rregullat e Tregut. Pas vlerësimit të kërkesës dhe duke pasur parasysh gjendjen aktuale në Sistemin e Transmisionit, Bordi i ZRRE ka parë të arsyeshme që të lejoj shtyrje të afatit në zbatimin e dispozitave të Kodit të Matjes dhe dispozitave të Rregullave të Tregut në afatet e vendosura si në Shtojcë.

Të gjitha dispozitat tjera të Kodit të Matjes dhe Rregullave të Tregut mbesin në fuqi.

II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund ti drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Kopje: Raporti i Derogimeve për Kodin e Matjes dhe Rregullat e Tregut.

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së

Krenar Bujupi, u.d. kryesuesit

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar